



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 27 maj 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Bujar Bukoshi, Armend Zemaj, dhe Teuta Hadri.

Munguan: Sllobodan Petroviq, Gjylnaze Syla dhe Qamile Morina.

Të pranishëm:

nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative,
nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri,
nga NDI - Shefki Kastrati,
nga USAID - Haxhi Gashi,
nga OSBE - Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë para miratimit në parim**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Mimoza Ahmetaj - Propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të diskutohet me grupet e interesuara për këtë projektligj para se të jetë pikë e rendit të ditës për shqyrtim.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë para miratimit në parim

Sadik Idriz – Tha se Projektligji për punë është proceduar në Kuvend. Komisioni ka të drejtë ta shqyrtojë këtë projektligj para leximit të parë dhe ta japë vlerësimin nëse ai duhet ta kalojë leximin e parë në Kuvend ose duhet t'i kthehet Qeverisë. Me qëllim të mbledhjes së informatave lidhur me këtë ligj propozoj që të organizohet një dëgjim publik, të angazhohet një ekspert për një lëmi të cilën do ta përcaktojë Komisioni, si dhe, nëse mund të sigurohet financimi, të organizohet një udhëtim në një nga shtetet e rajonit, si Sllovenia, Kroacia për të parë nga afër se si zbatohet ligji i punës. Gjatë mbledhjeve të ardhshme Komisioni do ta caktojë raportuesin për këtë projektligj dhe grupin e punës. Ai tha se do të ishte mirë ta marrim edhe një sqarim më të hollësishëm nga Qeveria nëse mund të zbatohet ky ligj, në mënyrë që të mos punojmë shumë dhe në fund ligji të tërhiqet për shkak të pamundësisë financiare për zbatim.

Mimoza Ahmetaj - Kërkoj që Komisionit t'i dorëzohet nga një kopje e ligjeve nga vendet e rajonit, në mënyrë që të analizohen praktikat rajonale sa i përket Ligjit të punës.

Nurishahe Hulaj –Tha se ky ligj është proceduar për herë të dytë në Kuvend. Në mandatin e kaluar është punuar shumë në këtë ligj - janë organizuar dëgjime publike me të interesuarit dhe janë angazhuar ekspertë. Ajo propozoi që të shqyrtohet dhe të analizohet me kujdes materiali nga mandati i kaluar për këtë projektligj, pastaj të përcaktohet grupi i punës, që duhet të jetë më i zgjeruar, pasi ky projektligj kërkon një përkushtim të veçantë. Sipas deklaratës, nga Departamenti për Buxhet, thuhet se ky ligj nuk është paraparë në kornizën afatmesme buxhetore dhe do të financohet nëpërmjet rrjedhjes së buxhetit të Kosovës, andaj Komisioni duhet të kërkojë nga sponsoruesi të dhëna të sakta nëse Ligji për punën do të jetë i zbatueshëm. Duhet të merret parasysh edhe fakti se nga ky ligj del nevoja edhe për shumë ligje specifike.

Teuta Hadri- Tha se ky projektligj për herë të dytë është proceduar në Kuvend. Në mandatin e kaluar është punuar shumë lidhur me këtë projektligj, andaj e konsideroj të panevojshëm organizimin e dëgjimeve publike. Komisioni mund t'i shqyrtojë materialet e punës nga mandati i kaluar dhe nëse dikush ka propozime të reja, ato mund të shqyrtohen në Komision dhe të vazhdohet tutje me procedimin e këtij ligji.

Ajo konsideron se më e arsyeshme është të bëhet sa më shpejt ligji dhe më vonë, nëse ka nevojë, mund të pësojë ndryshime.

Flora Brovina –Tha se Ligji i punës është ndër ligjet më të rëndësishme për Kosovën. Edhe pse sipas deklaratës së Qeverisë ky ligj nuk është në kornizën afatmesme buxhetore, megjithatë Qeveria prioritet e ka zhvillimin ekonomik- këtu hyn edhe ky projektligj.

Në mandatin e kaluar vërejtja kryesore e ekspertit ka qenë se Projektligji për punën është i cunuar, pastaj implikimet e mëdha buxhetore kanë bërë që ky ligj të mos jetë i zbatueshëm. Ajo u pajtua me propozimin për angazhimin e ekspertit dhe për organizimin e dëgjimeve publike me të gjithë të interesuarit, si: punëdhënësit, gratë, personat e punësuar dhe të papunësuar etj.

Ajo mendon se nga shtetet e rajonit më funksional është ligji i punës i Maqedonisë dhe i Sllovenisë. Është mirë që Komisioni të njihet me praktikatat e këtyre shteteve.

Armend Zemaj – Tha se pajtohet me mendimin që të kemi të dhëna nga Qeveria se sa do të jetë i zbatueshëm ky ligj. Ai e konsideron shumë të nevojshëm organizimin e dëgjimeve publike për shkak të karakteristikave që paraqiten me këtë projektligj, pa e anashkaluar edhe angazhimin e eksperteve dhe organizimin e ndonjë vizite në një nga vendet e rajonit, në mënyrë që anëtarët e Komisionit të njihen më për së afërmi me praktikatat e shteteve në zbatimin e Ligjit të punës. Komisioni duhet ta përkrahë këtë projektligj që të kalojë në leximin e parë në seancë të Kuvendit.

Haxhi Gashi (USAID) - Tha se USAID-i do ta mbështesë këtë Komision lidhur me amendamentin e Ligjit të punës. Projektligji i proceduar në këtë mandat është më i sistemuar në krahasim me Projektligjin në mandatin e kaluar. Është më i qartë, sepse nuk i përfshin shërbyesit civilë. Kategoria e shërbyesve civilë e ka një tretman tjetër. Ai propozoi që Komisioni ta kërkojë një deklaratë më të detajuar financiare nga Ministria për Ekonomi dhe Financa për implikimet buxhetore.

Mimoza Ahmetaj - Tha se sipas rregullores së UNMIK-ut shërbyes civilë janë të gjithë ata persona që paguhën nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Projektligji për punën i përjashton shërbyesit civilë, do me thënë titulli i Projektligjit është i gabuar, krijon konfuzion.

Nurishahe Hulaj – Tha se çështja e punëtorëve në organizata publike do të rregullohet me ligj të veçantë. Ky ka qenë edhe propozimi i ekspertit të angazhuar në mandatin e kaluar. Ministria e Shëndetësisë po insiston që punëtorët shëndetësorë të mos përfshihen në kategorinë e shërbyesve civilë.

Sadik Idriz - Tha se në fazën kur do shqyrtohet në mënyrë të detajuar ky projektligj do të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe sponsoruesit në mënyrë që Komisioni t'i mbledhë informatat e nevojshme duke mos i përjashtuar këtu edhe diskutimet e deputetëve në seancë gjatë leximit të parë të këtij projektligji.

Bujar Bukoshi –Tha se Ligji për punën është shtyllë e këtij vendi. Duhet të kemi kujdes në marrjen e praktikave të huaja, sepse Kosova i ka specifikat e veta. Në Kosovë është një situatë jonormale - punëdhënësi më i madh është Qeveria. Me kujdes duhet të shikohen mundësitë financiare, sepse çdo ditë nuk mund të bëhen ndryshime në ligjet bazike.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë

Përfundim

**Projektligji për punën mund të procedohet për miratim në parim në seancë.
Plotësimi dhe amendamenti i Projektligjit për punën do të bëhet gjatë shqyrtimit nga Komisioni pas miratimit në parim nga Kuvendi.**

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me qëndrimin e Qeverisë për Ligjin për ushqimin. Ai tha se sipas këtij njoftimi, qëndrimi i Qeverisë është: Agjencioni për ushqim i përcaktuar me nenin 36 të Projektligjit për ushqim të kalojë në kuadër të Qeverisë përkatësisht në Zyrën e Kryeministrit.

Flora Brovina – Lidhur me Ligjin për rehabilitimin profesional dhe aftësimin e personave me aftësi të kufizuara, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur vërejtje që kanë të bëjnë me amendamentet dhe punën që është bërë në këtë komision. Vërejtjet kanë të bëjnë me faktin se ky ligj nuk përputhet me ligjet për menaxhimin e financave dhe me Ligjin e doganave. Ajo shprehu keqardhjen pse të kthehet ky ligj, sepse është një ndër ligjet më humane që e ka Kosova dhe i njëjti do të ishte mjaft tërheqës për donatorët.

Sadik Idriz -Tha se ndoshta do të duhej t'i drejtohem me shkrim Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të na njoftojnë për qëndrimet e tyre lidhur me këtë ligj.

Nurishahe Hulaj - Tha se sipas planit të punës është paraparë që ky komision do t'i monitorojë disa nga ligjet që janë në fushëveprimtarinë e këtij komisioni. Ajo propozoi që Komisioni të përcaktohet se cilin ligj do ta monitorojë dhe ta bëjë një raport për shkallën e zbatimit të atij ligji. U propozua që të monitorohet Ligji për shëndetin riprodhues.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 12:10

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz